**LIGJ**
**Nr.10 466, datë 6.10.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8386, DATË 30.7.1998 "PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E SHITJES SË PRONAVE TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të pikës 9.1 të nenit 9 të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pronave të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", të ndryshuar, hiqen fjalët "vetëm kur hapet ankandi".

Neni 2

Çdo ligj apo akt nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7129, datë 25.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**